



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Kaçanik
Skupština Opština
Municipal Assambly
01Nr. 400-6297/2011
Kaçanik, 05.07.2011

Në bazë të nenit 40.2 (b) të Ligjit nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4 të Ligjit nr. 03/L-77 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, nenit 30 të Ligjit nr.03/L-048- Mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 14 dhe 15 të Ligjit nr.04/L-001 të Bugjetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011, të pikës 5 të Vendimit 01Nr.05-5316/10 të datës 24.09.2009- Për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin 2011 dhe vlerësimet për vitet 2012-2013, të nenit 34.5 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës si dhe nenit 15.1(b) të Rregullorës për Punë, më Rekomandim të KPF-a të datës: 30.06.2011 për Aprovimin e propozim vendimit të kryetarit të komunës 01Nr. 400-6297/2011- Për transferin e mjeteve nga ndarjet buxhetore mbi buxhetin e komunës për vitin 2011, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 05.07.2011, mori këtë:

VENDIM
PËR TRANSFERIN E MJETEVE NGA NDARJET BUXHETORE
MBI BUXHETIN E KOMUNËS PËR VITIN 2011

I.

Me këtë Vendim lejohet transferi intern i mjeteve buxhetore nga ndarjet me Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin 2011, përkatësisht realizimi i procesit të ndryshimeve dhe plotësimeve brenda programeve –nënprogrameve buxhetore dhe brenda për brenda kategorive të njëjta të shpënzimeve, duke mbetur i pandryshuar në total buxheti i miratuar sipas ndarjeve fillestare në masë monetare prej: **5,461,193.-€**.

II.

Me ndryshimet dhe përshtatjet e reja konform pikës I. të këtij Vendimi, do të bëhen transferet interne në programet dhe nënprogramet buxhetore brenda kategorisë ekonomike të Pagave dhe Mëditjeve, si dhe ridestinimi –transferi i brendshëm i shumave të mjeteve investive të projektet kapitale, ashtu siç janë pasqyruar në tabelarët e bashkangjitur, të cilat janë pjesë përbërse e këtij vendimi.

III.

Obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit që më Departamentet të MF-së të bëjë harmonizimin dhe zbatimin e këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve buxhetore sipas këtij vendimi.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe do të vlejë për derisa nuk mirret ndonjë vendim tjetër.

V.

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim si dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit,
z. Xhelal Gashi
